



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA KORÇË
KËSHILLI BASHKIAK**

**RAPORT MBI SESIONIN INFORMUES PËR QYTETARËT
ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I KËSHILLIT BASHKIAK &
PJESËMARRJA QYTËTARE NË VENDIMMARRJE**

Organizuar nga: Këshilli Bashkiak Korçë në bashkëpunim me Kryetarin e Bashkisë.

Data e zhvillimit: 17 shtator 2025.

Vendi: “Salla e Këshillit Bashkiak”.

Numri i pjesëmarrësve: Rreth 48 qytetarë (22 femra dhe 26 meshkuj).

Koha e zhvillimit: 11:00–12:30.

Transmetimi Live: Në Facebook dhe në kanalin zyrtar të YouTube të Këshillit Bashkiak (<https://fb.watch/CfHbKSeFp3/>)

Njoftimi për publikun: Ftesat u ndanë dhe njoftimi në rrjetet sociale (<https://www.facebook.com/KeshilliBashkiakKorce/posts/1097232172603881>) u bë një javë përpara datës së sesionit, si edhe dy ditë përpara dërguan e-maile dhe u bënë telefonata me grupet kryesore të interes, (të rinjtë, bizneset, OJF-të etj).

Qëllimi i Aktivitetit

Ky sesion informues u organizua me qëllim rritjen e transparencës dhe përfshirjes qytetare në proceset vendimmarrëse vendore, përmes prezantimit të strukturës, rolit dhe funksionimit të Këshillit Bashkiak si organ përfaqësues dhe ligjvënës në nivel vendor, si edhe si një mundësi për të gjithë qytetarët që të jepnin sugjerimet e tyre për një bashkëpunim më të mirë me këshillin bashkiak dhe pjesëmarrje më të madhe në vendimmarrje. Nga ana e Kryetares së Këshillit u kërkuar që fokusi kryesor ishte për të njoftuar qytetarët për mundësitë dhe rrugët e ndërveprimit të komunitetin me Këshillin e Bashkisë për tu bërë pjesë e vendimmarrjes dhe e konsultimeve.

Agjenda e Sesionit

- Hapja e aktivitetit dhe përshëndetja hyrëse** – nga **Sekretarja e Këshillit Bashkiak**, e cili theksoi rëndësinë e këtij aktiviteti si një instrument i dialogut dhe transparencës institucionale.
- Prezantimi kryesor mbi organizimin dhe funksionimin e Këshillit Bashkiak** – i mbajtur nga **Kryetarja e Këshillit Bashkiak**, i cili:
 - Sqaroi rolin e këshillit si organ përfaqësues dhe përgjegjës për miratimin e buxhetit, vendimmarrjen për çështje të rëndësishme të jetës komunitare, dhe mbikëqyrjen e veprimtarisë së ekzekutivit.
 - Ilustroi ndarjen e kompetencave ndërmjet Këshillit Bashkiak dhe Bashkisë.
 - Sqaroi mënyrën e funksionimit të mbledhjeve të këshillit, rolit të komisioneve të përhershme, transparencës së vendimeve dhe angazhimit për pjesëmarrje qytetare.
 - Dha të dhëna të përgjithshme për transparencën (fonde të shpenzuara, ankesa kërkesa të trajtuara, konsultime publike të zhvilluara etj).
 - U prezantuan mënyrat e ndërveprimit të komunitetit me Këshillin bashkiak (rrjetet sociale, ankesat/kërkesat, ndërfaqja e Këshillit në internet, publikimet e regjistrave etj).
- Diskutime dhe pyetje nga të pranishmit** – Qytetarët shprehën interes dhe bënë pyetje mbi:
 - Mundësitë për të paraqitur kërkesa apo propozime nga qytetarët;
 - Përdorimi i fondeve publike;
 - Raportimi i drejtpërdrejtë dhe transparenca në mbledhje.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË KËSHILLI BASHKIAK

- o Menyrat si mund të ndërveprohet me grupet e interes, sidomos shoqatat për çështje të cilat kanë lidhje me aktivitetin e tyre.
- o Çështje konkrete në lidhje me systemin e parkimit me pagesë dhe bashkëpunimi me bizneset në këtë drejtim.

Pjesëmarrësit në Aktivitet

- Kryetari i Këshillit Bashkiak
- Drejtorë të Bashkisë
- Sekretari i Këshillit Bashkiak
- Këshilltarë Bashkiakë të pranishëm
- Qytetarë nga komuniteti vendor

Elementë të Dokumentuar

- Transmetimi i sesionit është regjistruar dhe arkivuar në platformat e Këshillit Bashkiak (Facebook dhe YouTube).
- Fotografitë dhe materialet vizuale janë përgatitur për qëllime komunikimi publik dhe arkivim

Rezultatet dhe Vlerësimi i Aktivitetit

- Aktiviteti u vlerësua pozitivisht nga të pranishmit si një hap i rëndësishëm për përfshirjen qytetare.
- Pyetjet e shumta dhe diskutimet treguan një nivel të lartë interesi për proceset e vendimmarrjes.
- Transmetimi live ka mundësuar ndjekjen e aktivitetit edhe nga qytetarë që nuk ishin fizikisht të pranishëm, duke rritur transparencën.

Vazhdimësia

Bazuar në interesin dhe rëndësinë e këtij sesioni, **Këshilli Bashkiak ka vendosur ta shndërrojë këtë sesion informues në një traditë vjetore**, si pjesë e angazhimit për:

- Rritjen e transparencës institucionale
- Forcimin e pjesëmarrjes qytetare
- Edukimin demokratik të komunitetit

Sugjerime për Sesionet e Ardhshme

1. **Zgjerimi i fushatës së informimit** për të rritur më shumë akoma pjesëmarrjen – përfshirë njoftime në media lokale dhe kontaktimi i drejtpërdrejtë me organizata vendore dhe persona publik që kanë ndjekës të shumtë në rrjetet e tyre sociale për të bërë në to njoftimin për sesionin informues.
2. **Përdorimi i pyetësorëve për feedback** në fund të sesionit për të matur ndikimin dhe përmirësuar formatin.
3. Krijimi i mundësive të kontakteve direkte për çështje specifike, ku këshilli të kontaktojë direct me komunitetin/grupin e interes.
4. Këshilli mund të luajë fare mirë rolin e ndërmjetësit midis grupeve të interes për çështje të caktuara dhe administratës (rast konkret për parkimet e dedikuara për bizneset hotelerike)

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Eva Naçi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KORÇË
KËSHILLI BASHKIAK

Foto nga aktiviteti.

